



Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prudato Received/Delivaty	28.12.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Org /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTK	8543/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1005/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1005/2022, të datës 14.11.2022 të ankuesit

kundër Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë i Komunës së Prishtinës të datës 02.11.2022, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2022, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1005/2022 e datës 14.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë i Komunës së Prishtinës i datës 02.11.2022 si dhe Njoftimi e datës 25.10.2022 lidhur me dy kandidatët e përzgjedhur si kandidatët më të suksesshëm.

A r s y e t i m

Ankuesi i cila sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" të shpallur nga Komuna e Prishtinës, me datë 14.11.2022 nëpërmjet adresës zyrtare elektronike ankesa.kpmshtk@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër:7059/2022, kundër Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të

Lëvizjes Brenda Kategorisë i Komunës së Prishtinës të datës 02.11.2022 si dhe kundër Njoftimit Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 25.10.2022.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Komisionit i Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë, tutje (Komisioni i Vlerësimit) ka zbatuar gabimisht dispozitat e aplikuara ligjore të ligjit material, pasi që kandidatët e përzgjedhur sipas Njoftimit të datës 25.10.2022 nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit ndërlidhur me përvojën profesionale të punës prej dy (2) vitesh.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Ferizajt. Ndërsa me datë 29.11.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.11.2022 parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Njoftimi përfundimtarë për kandidatët fitues i datës 25.10.2022; E-mailin e ankuesit të datës 14.11.2022 dërguar në Këshill me shkresat e bashkangjitura të ankesës; Njoftimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 14.10.2022; Njoftimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 21.10.2022 dërguar për ankuesin nëpërmjet e-mailit; Njoftimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 02.11.2022; Vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë të datës 02.11.2022; Konkursin e shpallur të datës 20.09.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.11.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 29.11.2022; Vendimin për themelimin e Komisionit të Vlerësimit i datës 12.07.2022; Akt Emërimit e datës 11.11.2019 me numër:112-1075; Akt Emërimit e datës 01.03.2022 me numër:112-1126; Akt Emërimit e datës 01.03.2022 me numër:112-1054; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 08.09.2022; Akt Emërimit e datës 01.12.2021 me numër:112-1126; Listën e aplikantëve; Aplikacionin e kandidatit B.A të datës 08.10.2022 me shkresat e bashkangjitura të dosjes; Diplomën e datës 09.10.2018 me numër:1863; Diplomën e datës 11.07.2016 me numër:610/16; Çertifikatën e datës 28.07.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë; Pasqyrën e llogarisë së trustit të llogarisë aktive 5203217583; Kontratën e punës të datës 01.09.2016; Akt Emërimit e kandidatit B.A të datës 24.07.2022; Akt Emërimit e kandidatit B.A të datës 07.09.2018; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 07.09.2018; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 09.02.2022; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit B.A; Formularët e Vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020 dhe 2021 të kandidatit B.A; Vërtetimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 21.07.2021; Aplikacionin e kandidates F.R të datës 05.10.2022 me shkresat e bashkangjitura të dosjes; Diplomën e datës 08.08.2014 me numër:108/14; Diplomën e datës 05.01.2018 me numër:128/17; Vërtetimin e datës 20.09.2022; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë të datës 03.10.2022; Vërtetimin e datës 30.01.2014 lëshuar nga Hortikultura; Kontratën e punës të datës 01.01.2012 lëshuar nga Hortikultura; Akt emërim e kandidates F.R i datës 06.07.2012; Akt emërimit e kandidates F.R i datës 01.02.2017; Kopjen e letërnjoftimit të kandidates F.R; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 dhe 2021; Vërtetimin e datës 20.09.2022; Aplikacionin e ankuesit I.K të datës 06.10.2022 me

dokumentacion e dosjes së bashkangjitur; Diplomën e datës 08.02.2010 me numër:792; Diplomën e datës 15.06.2015 me numër:899; Vërtetimin e datës 06.04.2022 lëshuar nga Noter H.L; Vërtetimin e datës 153.05.2019 të lëshuar nga Dauti-Komerc; Akt Emërimit të ankuesit të datës 20.05.2019; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 dhe 2021 të ankuesit; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykatat Themelore në Ferizaj -Dega Kaçanik të datës 09.02.2022; Çertifikatën e shtetësisë e datës 16.07.2021; Aplikacionin e kandidatës M.P me dokumentacionin e dosjes së bashkangjitur; Çertifikatën e datës 11.06.2013; Diplomën e datës 01.04.2011 me numër 2048; Vërtetimin e datës 07.02.2011 të lëshuar nga Avokat K.R; Kontratën e punës të datës 01.07.2019 të lëshuar nga Avokat K.R; Kontratën e punës të datës 01.08.2010 të lëshuar nga N.N.P "Pro-Ing" Vërtetimin e datës 02.12.2011 lëshuar nga "Pro-Ing"; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës i datës 08.07.2014; Akt emërimit të kandidatës M.P i datës 04.07.2014; Marrëveshjen për kryerjen e Shërbimeve të Veçanta e datës 15.12.2014; Vendimin e Kryetarit të Komunës së i datës 10.04.2015; Akt emërimit të kandidatës M.P i datës 10.04.2015; Akt emërimit të kandidatës M.P i datës 02.03.2016; Akt emërimit të kandidatës M.P i datës 01.02.2017; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatës M.P; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykatat Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë të datës 03.10.2022; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 dhe 2021 të kandidatës M.P; Vërtetimin e Njësisë së Personelit të datës 20.09.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, SEPSE:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Prishtinës me datë 20.09.2022 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit për pozitën "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" me numër të Referencës: RN00009990, dy (2) pozita, për lëvizje brenda kategorisë, ndërsa bazuar në aplikacionin e ankuesit të datës 08.10.2022 konstatohet fakti se ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër të Referencës: RN00009990, ndërsa i njëjti rezulton të mos jetë kandidat i suksesshëm.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin e shpallur nga Komuna e Prishtinës për pozitën "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" me numër të Referencës: RN00009990, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a të studimeve Universitare me të paktën 240 kredi/ETC apo ekuivalente me to (në rastin e kur kredi janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor.
- **Kualifikime të posaçme formale:** Diplomë Juridik, Gjeodezi
- **Përvoja e punës:** Se paku dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Nga se u tha me lartë, po ashtu Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi kishte marrë pjesë në procedurën e rekrutimit për pozitën e lartcekur sikurse edhe kishte kaluar në fazën e verifikimit paraprak, mirëpo pavarësisht që ishte ftuar përmes e-mailit të datës 21.10.2022 nga



Njësia e Burimeve Njerëzore që të marr pjesë në intervistën me gojë e cila do të mbahej me datë 24.10.2022, i njëjti rezultoi se nuk kishte marr pjesë, ndërsa bazuar në Njoftimin e datës 25.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, për konkursin e shpallur pas përfundimit të gjitha fazave të vlerësimit si kandidatë të suksesshëm për dy pozitave e punës rezultoi të jenë kandidatët: F.R me 81.4% të pikëve dhe M.P me 80.2% të pikëve.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me plotësimin e përvojës së punës së dy kandidatët e suksesshëm nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit sa i përket përvojës profesionale të punës në fushën (Kadastër-Gjeodezi), nga shkresat e administruara të dosjeve të dy kandidatëve dhe ka ardhur në përfundimin se kandidatja e suksesshme F.R në bazë të Akt Emërimit të datës 01.02.2017 si dhe Vërtetimit të datës 20.09.2022, konstatohet se e njëjta është në marrëdhënie të punës në pozitën "Asistente Administrative 4" mbi dy (2) vite përvojë punë në kuadër në kuadër të Drejtorisë së Kadastrit, gjegjësisht në Drejtorinë në të cilën është realizuar procedura e rekrutimit dhe po ashtu kandidatja e suksesshme M.P në bazë të Akt Emërimit të datës 04.07.2014 konstatohet se ka qenë në marrëdhënie të punës në pozitën "Zyrtare e Lartë për komunikim me palë", ndërsa mbi bazën e akt emërimit të datës 01.02.2017 e njëjta mban pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime me Qytetar" në kuadër të Drejtorisë së Administratës, nga rrjedh se kandidatja e suksesshme M.P ka mbi dy (2) vite përvojë punë në kuadër Drejtorisë së Kadastrit, gjegjësisht në Drejtorinë në të cilën është realizuar procedura e rekrutimit për plotësimin e pozitave të lira "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi", andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia e Pranimi me rastin e vlerësimit se të dy kandidatet e suksesshme i kanë plotësuar kushtet e konkursit lidhur me përvojën e punës, kanë vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës neni 41 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 si dhe paragrafi 3 ku përcaktohet se: "Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2.Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë", pasi që të dy kandidatet kanë përvojë të punës në fushën e të njëjtës Drejtori, gjegjësisht të Drejtorisë së Kadastrit në kuadër të së cilës drejtori do të sistemohen edhe dy zyrtarët për pozitën e rekrutuar.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të dhëna bazuar në konstatimet e dhëna si ma lartë si dhe shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën për pozitën "Zyrtar i Lartë për Kadastër dhe Gjeodezi" me numër të Referencës: RN00009990, dy (2) pozita, për lëvizje brenda kategorisë të shpallur me datë 20.09.2022 nga Komuna e Prishtinës është zhvilluar në pajtueshmëri me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave

përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive", ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me përvojën e punës së dy (2) kandidatëve të suksesshme është i pabazuar, shtuar faktin kësaj që ankuesi nuk kishte marr pjesë në fazën përfundimtare (intervistën me gojë) të procedurës së rekrutimit, rrjedhimisht mungesa e të njëjtit në intervistë nuk ka mund të prodhojë rezultate të ndryshëm të poentimit të pikëve të vlerësimit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.931/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.